



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

|  |                               |                               |                               |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar<br>Priljena/Produato<br>Received/Delivery | 23.02.2022                    | 2                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jedinstvo<br>Org./Unit               | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKIMSHICK  | 968/2022                      |                               | 1/4                           |



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.09/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.09/2022 të datës 11.01.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Prishtinë, kundër Vendimit me numër DM 1249/2021 të datës 16.12.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike “Transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 23.02.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.09/2022 e datës 11.01.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër DM 1249/2021 i datës 16.12.2021 i Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

### A r s y e t i m

Kryesues i Njesisë për Përfaqësim Ligjorë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është kthyer në vendin e punës me Vendimin e datës 14.12.2021 të zëvendësuesit Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas Akt emërimit me numër të reference 35/DL 9 të datës 18.08.2014, bazuar në Aktvendimin me numër PKR.nr.130/16 të datës 08.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special i cili është bë i plotfuqishëm me datës 15.11.2021.

Me datë 16.12.2021 Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ka nxjerrë Vendimin me numër DM 1249/2021 me të cilin ankuesi është transferuar përkohësisht në pozitën „ Kryesues i Komisionit të Listave të 20% të Punëtorëve“, Departamenti i Komisioneve Profesionale me gradë/hap 3-6 nga pozita „ Kryesues i Njësisë për Përfaqësime Ligjore“ gradë/hap 3-6, për periudhë gjashtë (6) muaj nga data 16.12.2021 deri me datë 15.06.2022, për interes të institucionit.

Kundër Vendimit me numër DM 1249/2021 të datës 16.12.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datës 11.01.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 51/2022, duke pretenduar se Vendimi i datës 16.12.2021 është i kundërligjshëm dhe se është hakmarrje personale ndaj tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Agjencia Kosovare e Privatizimit për përgjigje në ankesë, ndërsa me datë 31.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.prot:51/2022 të datës 11.01.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.7207 i datës 19.09.2014; Kërkesë e datës 17.11.2021; Kallëzim penal- Zyra e pranimit në Prokurori të Shtetit i datës 06.12.2021; Vendimi me numër DM 1249/2021 i datës 16.12.2021 i Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Vendimin e datës 14.12.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Përgjigje në ankesë e datës 31.01.2022; Akt emërimin me numër reference 35/DL 9 të datës 18.08.2014; Aktvendimit PKR.nr.130/16 të datës 08.11.2021 i plotfuqishëm me datës 15.11.2021i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special; Vendimi nr.protokolli138 i datës 12.01.2015; E-mail zyrtar i datës 16.12.2021;Vendim i datës 28.09.2021; E-mail zyrtar i datës 23.12.2021; Urdhër obligim për pagës i datë 21.12.2021; Shkresë zyrtare e datës 25.11.2021 me numër protokolli 4940 nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës; Pasqyra e pagesës për periudhën nga data 19.09.2014 deri me datës 31.12.2019; Vendimi i datës 07.10.2021 me nr.ref:BD-152/1 i nxjerrë nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se pretendimet ankimore, kundër vendimit mbi transferimin e përkohshëm të ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me numër DM 1249/2021 i datës 16.12.2021 mbi transferimin e përkohshëm, është nxjerrë kundërligjshëm dhe është hakmarrje personale ndaj tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar provat e lëndës secilën veç e veç, si të ankuesit dhe organit të punësimit gjegjësisht Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara sepse Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 16.12.2021, ka nxjerrë Vendim me nr.DM 1249/2021 me të cilin ankuesin e ka transferuar përkohësisht në pozitën „ Kryesues i Komisionit të Listave të 20% të Punëtorëve“, Departamenti i Komisioneve Profesionale me gradë/hap 3-6, nga pozita „ Kryesues i

*Njesisë për Përfaqësime Ligjore* gradë/hap 3-6, për periudhë gjashtë (6) muaj nga data 16.12.2021 deri me datë 15.06.2022, për interes të institucionit duke vepruar në pajtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, është përcaktuar se: *"Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve"*, duke u lidhur me nenin 4 paragrafin 1 paragrafin 4 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit", 4."Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit"....., dhe 5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme"*, që në rastin konkret Zëvendësuesi Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pasi ka bërë vlerësimin e gjendjes aktuale me rastin e pensionimit të nëpunësit civil që ka qenë në pozitë të Departamentit të Komisioneve Profesionale, ka vlerësuar se janë krijuar kushtet që ankuesi të transferohet përkohësisht për periudhën gjashtë (6) muaj, në pajtim me dispozitat e lartë cekura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se refuzimi i caktimit të transferimit të përkohshëm bëhet nëse nëpunësi civil, dëshmon me prova se nuk mund të ushtroj detyrën e caktuar përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, që përcakton se: *"3.Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: 3.1. kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 100 km nga vendbanimi i nëpunësit civil"*, dhe në rastin konkret duke u bazuar në provat e lëndës ankuesi nuk e ka vërtetuar me asnjë provë se ka dëshmi që lidhet me rastet e përcaktuar si në këtë dispozitë, andaj refuzimi i transferimit si i tillë nuk është i mundur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka vendosur që pretendimet e tjera të ankuesit se transferimi i është bërë me tendencë (hakmarrje) nuk janë të bazuara dhe nuk qëndrojnë sepse duke u bazuar në provat e lëndës ankuesi me asnjë provë nuk ka dëshmuar se veprimet e zëvendësuesit Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, janë bërë për çështje tjera personale, lidhur me faktin se transferimi i përkohshëm gjashtë (6) muaj, është bërë për arsye të nevojave institucionale në pajtim me nenin 52 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me rastin e pensionimit të nëpunësit civil të Departamentit të Komisioneve Profesionale, lidhur për faktin se ankuesi ka Akt emërimin me numër reference 35/DL 9 të datës 18.08.2014, të karrierës pa afat, në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër DM 1249/2021 i datës 16.12.2021, i Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për transferimin e përkohshëm të ankuesit është bërë për nevojat e punës dhe për interes të Institucionit gjegjësisht është kërkuar plotësimi i pozitës me rastin e pensionimit të nëpunësit civil me qëllim të mbarëvajtjes së punëve, andaj Kolegji konstaton se Vendimi është në nxjerre në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.09/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së;